



N J O F T I M

Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror "22 Nëntori" në pajtim me Ligjin për çmime shtetërore, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çmime shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/06, 54/07, 74/12, 99/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së numër 98/19) dhe Rregulloren e Punës së Këshillit, në mbledhjen e fundit miratoi

V E N D I M

për ndarjen e çmimit shtetëror "22 Nëntori" në vitin 2019 për mirënjohjen e njerëzve nga jeta politike, kulturore dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kanë kontribuar në avancimin e bashkëjetesës ndërnjëzore dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, kulturave dhe feve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

1. Për arritjet në fushën e jetës politike, kulturore dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kanë kontribuar në avancimin e bashkëjetesës ndërnjëzore dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, kulturave dhe feve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çmimi u ndahet:

- David Hosaflok; studiues, historian dhe humanist
- Kimete Agai dhe Adnan Agai; arsimtarë

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Çmimi do t'u dorëzohet fituesve më 22 nëntor 2019 (e premte) në orën 13:00 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Kryetare e Këshillit,
prof. dr. Gëzime Starova**